



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinijeno/Prodato Received/Delivery	22 - 11 2021	viti god year	
Organ/Njesta Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHOK	5587/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.904/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.904/2021 të datës 04.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë Objekti A, Hyrje 1, Nr.29, Kalabria e Re, në Prishtinë, kundër Vendimit DM 1190/2021 të datës 18.10.2021 të Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kompensim materail", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 22.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.904/2021 e datës 04.11.2021 e parashtruar nga ankuesja**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi DM 1190/2021 i datës 18.10.2021 i Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në Agjencisë Kosovare të Privatizimit në bazë të Akt Emërimit të datës 12.07.2021 në pozitën "Kryeses i Njesisë së Shkresave Gjyqësore", me datë 04.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5283/2021 te regjistruar me numër A.nr.904/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin të Vendimit DM 1190/2021 të datës

18.10.2021 të Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe për kompensimin e të ardhurave personale nga data 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave, me datë 08.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më datë 15.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5283/2021 të regjistruar me numër A.nr.904/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Vendimin A.nr.482/2021 të datës 29.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin DM 1146/2021 të datës 05.07.2021 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Akt Emërimit të datës 12.07.2021 në emër të ankueses; Vendimin DM 911/2019 të datës 31.10.2019 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vendimin DM 42/2020 i datës 04.02.2020 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Kërkesë për kompensimin e pagave të datës 19.08.2021 e parashtruar nga ankuesja për Drejtorin Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Pasqyra mujore e pagës për punonjës për muajin korrik 2021; Vendimin DM 1190/2021 I DATËS 18.10.2021 I Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.11.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 15.11.2021; Vendimin DM 1146/2021 i datës 05.07.2021 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vendimin DM 303/2017 të datës 25.08.2017 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Pasqyra mujore e pagës për punonjës për muajin nëntor, dhjetor 2019; Pasqyra mujore e pagës për punonjës për muajin janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2020; Pasqyra mujore e pagës për punonjës për muajin janar, mars, prill, maj, qershor dhe korrik 2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar sepse:*

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 13.11.2018, ka publikuar konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës "Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjqësore", në bazë të të cilit konkurs si kandidatë e suksesshme është rekomanduar ankuesja. Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk ka aprovuar rekomandimin e Komisionit Përzgjedhës, dhe përmes Vendimit me numër DM 701/2018 të datës 20.12.2018 ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën "Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjqësore". Pas shfrytëzimit të së drejtës së ankimit, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datë 08.02.2019 ka nxjerr Vendimin Nr.KZKA-3/2019 me të cilin vendim është aprovuar si e bazuar ankesa e

ankueses dhe është shfuqizuar Vendimi me numër DM 701/2018 i datës 20.12.2018 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke marr parasysh se vendimi i KZKA-se nuk është zbatuar, ankuesja ka vazhduar procesin e ankimit pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Fillimisht nuk është shqyrtuar ankesa e ankueses sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka qenë jofunksional, ndërsa pas Aktgjykimit A.nr.1112/19 të datës 27.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.06.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.482/2021 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankueses duke e obliguar Drejtorin Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit t'i lëshoj Akt Emërimin në pajtim me legjislacionin në fuqi për pozitën "Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore". Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka zbatuar vendimin e Këshillit, duke bërë lëshimin e akt emërimit për ankuesen më datë 12.07.2021.

Pas nënshkrimit të Akt Emërimit të datës 12.07.2021 sipas Vendimit A.nr.482/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja më datë 19.08.2021 ka parashtruar kërkesë të Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për kompensimin e pagave bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 18.10.2021 ka nxjerr Vendim DM 1190/2021, me të cilin ka hedhë poshtë si të pabazuar kërkesën e ankueses me arsyetimin që në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, dhe meqenëse e njëjta nuk ka pasur akt emërim të nënshkruar nuk mund të kompensohet për periudhën e kërkuar.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për anulimin të Vendimit DM 1190/2021 të datës 18.10.2021 të Zëvendës Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe për kompensimin e të ardhurave personale nga data 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës, konstaton se ankuesja pozitën Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore e ka ushtruar me vendim nga data 25.08.2017 deri më datë 31.10.2019 si ushtruese e detyrës, ndërsa nga data 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021 ankuesja ka ushtruar pozitën Zyrtar Dërgues respektivisht Zyrtar i Administratës. Andaj meqenëse ankuesja në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë vendim apo konfirmim zyrtar i cili dëshmon se e njëjta ka ushtruar pozitën Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore për periudhën 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021 Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për kompensim gjate kësaj periudhe është i pa bazuar. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke iu referuar Vendimit Nr.KZKA-3/2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i cili vetëm e shfuqizon Vendimin Nr.DM-701/2018 të datës 20.12.2018 të Drejtorit Menaxhues të AKP-së dhe nuk e anulon të njëjtin, me datë 28.06.2021 ka nxjerr Vendimin A.nr.482/2021 dhe ka obliguar Agjencinë Kosovare të Privatizimit të krijojë lidhje kontraktuale, gjegjësisht të lëshojë Akt emërimin për ankuesen për pozitën e punës

Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore, dhe jo të bëjë kompensimin sepse ka munguar lidhja kontraktuale në mes të punëmarrësit dhe punëdhënësit.

Pra, zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, siç parashihet me nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 9 paragrafi 1, ka përcaktuar që: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës", andaj meqenëse ankuesja nuk ka pasur asnjë akt juridik që ka ushtruar detyrat e punës së pozitën Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore nga data 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021, atëherë nuk mund të bëhet asnjë lloj kompensimin për këtë çështje, rrjedhimisht edhe pretendimi i saj për kompensimin e të ardhurave personale nga data 31.10.2019 deri më datë 06.07.2021 është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se Zëvendës Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit DM 1190/2021 të datës 18.10.2021 ka zbatuar drejt ligjin material duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, kështu që pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.904/2021

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.